



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2024:040744

Datë: 07.05.2024

Numri i dokumentit: 05659815

P.nr.48/24

NË EMER TË POPOULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen bashkëpunëtores profesionale Gentiana Dakaj, duke vendosur në lëndën penale kundër të pandehurit A. B. nga fsh. K.L., të cilin e akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP/II.nr.452/24, të datës 30.01.2024, për shkak të veprës penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e prokurorisë për dhënien e urdhrit ndëshkimor, jashtë seancës gjyqësore me datën 06.02.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PTH-së në Prishtinë, PP/II.nr.452/24, të datës 30.01.2024 dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

Ndaj të pandehurit:

A. B., i lindur me, në P., i biri i F. dhe Z., e gjinisë K., kurse jeton në fshatin A., Komuna e L., i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, dizajner, i punësuar në W., në P., me nr. personal, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa dënuar, mbrohet në liri.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me datë 18.12.2023, rreth orës 00:52, në L., i pandehuri A. B., me dashje dhe pa autorizim ka poseduar narkotik, substanca psikotrope apo analoge, në atë mënyrë që gjatë një kontrolli nga personat zyrtar në rr. "I. R." në hyrje të L., tek i pandehuri A. B. kanë gjetë dy qese të vogla, të cilat ishin të mbushura me substanca bimore të llojit marihuanë që përmban përbërje kimike tetrahidrokanabinol (THC), me peshë të përgjithshme prej 1.67 gram,-

Me këtë ka kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata, në konform të dispozitave të lartcekura dhe dispozitave të neneve 1, 2, 4, 6, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69 dhe nenit 269 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së si dhe neneve 493, 495 si dhe nenit 364 të KPPK-së, të pandehurin e gjykon:

ME DËNIM ME GJOBË

Me dënim me gjobë në shumë prej 300-€, të cilin dënim i pandehuri është e obliguar që ta paguaj në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në rast se dënimi nuk

realizohet as me detyrim, gjykata dënimin me gjobë do ta zëvendësojë me dënim me burgim, konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burg, të llogaritet shuma prej 20-€.

DETYROHET i pandehuri që kësaj gjykate, në emër të paushallit gjyqësor ti paguaj shumën prej 20-€, si dhe për kompensimin e viktimave të krimit ti paguaj shumën prej 20-€, në afat prej 15 dite nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

KONFISKOHET substanca naroktike të llojit Marihuanë me peshë 1.67 gram.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë me aktakuzën e saj PP/II.nr.452/24, të datës 30.01.2024, e ka akuzuar të pandehurin A. B. nga fsh. A., për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe njëkohësisht ka kërkuar që të pandehurit t'i shqiptohet urdhër ndëshkimor - dënim me gjobë për veprën e lartcekur penale.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi shqyrtoi provat që janë bashkangjitur aktakuzës respektivisht kallëzimit penal 2023-AH-1290 i datës 08.01.2024, raporti i policit hetues i dt.18.12.2023, raporti fillestar i incidentit dt.18.12.2023, procesverbal i dëshmisë/pronës dt.18.12.2023, procesverbal i marrjes në pyetje për të dyshuarin e dt.18.12.2023, procesverbal i marrjes në pyetje dëshmitarin M. M. i dt.18.12.2023, procesverbal i marrjes në pyetje dëshmitarin L. K. i dt.18.12.2023, raporti i oficerit dt.18.12.2023, si dhe fotot që gjinden në shkresat e lëndës erdhi në përfundim se ka prova të besueshme nga kallëzimi penal lidhur me bazueshmërinë e aktakuzës, në drejtim të vërtetimit të fakteve se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, prandaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe e gjykoji si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me dispozitën e nenit 493 të KPPK-së parashihet se “Për veprat penale për të cilat parashihet dënim me gjobë ose burgim deri në tri (3) vjet, për të cilat prokurori i shtetit është informuar në bazë të provave të besueshme nga kallëzimi penal, prokurori i shtetit mund të kërkojë në aktakuzë që gjykata të jep urdhër ndëshkimor, në të cilin të akuzuarit do t'i shqiptojë dënim përkatës pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor”.

Gjyqtari me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes konform nenit 495 të KPPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor ndaj të pandehurit nga arsyet se dënimi për veprën penale me të cilën ngarkohet i akuzuari është dënim me gjobë apo me burgim deri në 3 vite, andaj gjykata konform dispozitave të lartcekura vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor u bazua konform nenit 449 dhe 450 të KPPK-së, ndërsa vendimi për kompenzimin e viktimave të krimit u mur në bazë të nenit 36 të Ligji për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për konfiskim u bazua në nenin 269 par. 3 të KPRK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- DEGA NË LIPJAN
P.nr.48/24, me datën 06.02.2024

Bashkëpunëtori Profesional
Gentiana Dakaj

GJYQTARI
Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë në kundërshtim në afat prej 8 (tetë) dite nga dita e marrjes së të njëjtit, kundërshtimi i drejtohet gjyqtarit individual të kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2024:040744
Datë: 07.05.2024
Numri i dokumentit: 05659815